



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Data: 01.11.2016			
Titulli: Propozim Miratimi	Numri: 01-013/0351	Viti: 2016	
Orë: 10:00	Numri: 01-013/0351	Viti: 2016	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, neni 17 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinorë dhe neni 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më 31.10.2016, aprovon këtë:

## V E N D I M

### Për shpalljen në diskutim publik për propozim Planin e Mirëmbajtjes dhe Planit investiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë

#### Neni I

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozim Planin e Mirëmbajtjes dhe Planit Investiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë.

#### Neni II

Propozim plani nga neni 1 e këtij vendimi përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërës e këtij vendimi.

#### Neni III

Propozim plani nga neni 1 i këtij vendimi i lihet në dispozicion për diskutim publik të gjithë qytetarëve të interesuar, organeve dhe institucionet e Komunës së Vitisë, në afat prej 30 dite. Hapja e shqyrtimi publik do të bëhet më 18.11.2016 (e Premte), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti, duke filluar nga ora 10:00.

#### Neni IV

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të tij, propozim plani i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

#### Neni V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.

#### Neni VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Drejtorisë për Urbanizim, Planifikim
3. Drejtorisë për Kadastër, Pronë
4. MAPL
5. Shërbimit të Kuvendit
6. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT  
Naim Pira

